



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL

**PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA**  
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZL.A.nr.10/2025

**PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP)**, i përbërë nga gjyqtarët: Kujtim Pasuli kryesues, Bujar Muzaiqi dhe Hidajete Gashi Alaj, anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e [REDAKTUAR] me vendbanim në Winterthur, Zvicërr, të parashtruar ndaj vendimit të KQZ-së, me nr. Protokolli 01/2318/2025 datë 03.09.2025, për refuzimin e kundërshtimit administrativ në lidhje me aplikimin për regjistrim të votuesve jashtë Kosovës, për Zgjedhjet Lokale të Republikës së Kosovës që do të mbahen me datë 12 Tetor 2025, në seancën e panelit të mbajtur me datë 06.09.2025, mori këtë :

#### **V E N D I M**

**REFUZOHET e pabazuar** ankesa ZL.Anr.10/2025 datë 04.09.2025, e parashtruar nga [REDAKTUAR] me vendbanim në Winterthur, Zvicërr, kundër Vendimit me nr. Protokolli 01/2318/2025 datë 03.09.2025, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për shkak të mos regjistrimit si votues jashtë Kosove për Zgjedhje Lokale të Republikës së Kosovës që do të mbahen me datë 12 Tetor 2025.

#### **A r s y e t i m**

Me datë 04.09.2025, PZAP-i, përmes emailit zyrtar, ka pranuar një ankesë nga [REDAKTUAR] me vendbanim në Winterthur, Zvicërr, në të cilën thekson se ka aplikuar për regjistrim si votuese jashtë vendit në zgjedhjet Komunale dhe se Komisioni Qendror Zgjedhjeve (KQZ) ia ka refuzuar aplikimin me arsyetimin e mungesës së adresës së plote. Po ashtu në ankesë theksohet se pas marrjes së njoftimit nga KQZ, ka parashtruar ankesë dhe ka ofruar dëshmi shtesë të vlefshme të cilat e vërtetojnë adresën e vendbanimit jashtë Kosovës, mirëpo përkundër dorëzimit të këtyre dëshmive KQZ nuk e ka pranuar aplikimin. Ky veprim përben shkelje të nenit 45 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenit 6 të Ligjit Nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme, ku përcaktohet e drejta universale e qytetarëve të Kosovës për të votuar.

Parashtruesja kërkon nga PZAP që të konstaton se refuzimi i KQZ-së është i pabazuar, dhe të obligojë KQZ-në ta përfshijë në listën e votuesve jashtë vendit.

Parashtruesja në ankese ka bashkangjitur si dëshmi pasaportën dhe sigurimin shëndetësor me adresën e plotë të saj.



PZAP, iu ka drejtuar me datë 05.09.2025 me kërkesë për përgjigje KQZ-së lidhur me ankesën A.nr.10/2025 të parashtruar nga ankuesja [REDAKTUAR]

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), me datë 05.09.2025 ka parashtruar në PZAP, përgjigje në kërkesë.

Në përgjigje në kërkesë të KQZ-së, ndër të tjera thuhet se "... Shtetasja znj. [REDAKTUAR] (më tej parashtruesja e ankesës), me numër personal të Republikës së Kosovës [REDAKTUAR] ka aplikuar përmes platformës elektronike. Thekson se shërbimi për votues ka shqyrtuar aplikimin dhe aplikuesja është njoftuar përmes emailit, në email adresën e dhënë gjatë aplikimit [REDAKTUAR] për refuzimin e aplikimit të saj me arsyen e refuzimit: *"Mungon dokumenti që dëshmon adresën e banimit"*, meqë gjatë aplikimit nuk ka bashkangjitur dëshmi që dëshmon adresën jashtë Kosovës, sikurse është përcaktuar në rregulloren sikurse përcaktohet në nënparagrafin 4.4, të nenit 3, të Rregullores Zgjedhore Nr.04/2025, Regjistrimi dhe Votimit Jashtë Kosovës, ku thuhet: *"aplikuesi fotografon dokumentin që dëshmon adresën e votuesit jashtë Kosovës, sikurse në nën paragrafin 4.1."*. KQZ nuk ka pranuar kundërshtimin administrativ nga [REDAKTUAR] përmes emailit në adresën [kundershtimi.vjk@kqz-ks.org](mailto:kundershtimi.vjk@kqz-ks.org), ashtu sikurse e njëjta në ankesën në PZAP nuk ka dorëzuar dëshmi se ka paraqitur kundërshtim administrativ.

Paneli, pas shqyrtimit të ankesës së parashtruar nga ankuesi, gjeti se:  
**-Ankesa është e pabazuar.**

Paneli e vlerësoj lejueshmërinë e ankesës dhe ka ardhur në përfundim se e njëjta i plotëson kushtet e përcaktuara me nenin 98 paragrafi 3 të Ligjit NR.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, si dhe në nenin 4 të Rregullores për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave.

Paneli, pasi shqyrtoi lëndën, dhe vendimin me nr. Protokolli 01/2318-2025 datë 03.09.2025, të KQZ-së, konstatoi se i njëjti është i drejtë, dhe i ligjshëm, bazuar në këtë vlerësoi se ankesa është e pabazuar, pasi që parashtruesi i ankesës gjatë aplikimit të tij për regjistrim për votim jashtë Kosovës nuk i ka plotësuar kriteret e kërkuara sipas nenit 3, paragrafi 4 të Rregullores Zgjedhore Nr. 04/2025, për Regjistrimin dhe Votimin jashtë Kosovës të KQZ-së, në të cilin nen të të njëjtës Rregullore ndër të tjera thuhet se *"Kërkesa për regjistrim përmes platformës elektronike të KQZ-së bëhet duke plotësuar dhe bashkangjitur, përkatësisht neni 4.4:*

- *Fotografon dokumentin që dëshmon adresën e votuesit jashtë Kosovës, sikurse në nën paragrafin 4.1.*

Nga shkresat e lëndës, si dhe nga përgjigja e KQZ-se, Paneli vlerësoi se parashtruesja e ankesës në momentin e aplikimit për regjistrim për votim jashtë Kosovës, përmes platformës elektronike të KQZ-së, pavarësisht faktit që aplikuesja kishte bashkangjitur disa dokumente të kërkuara si kopje të pasaportës, dhe kopje të sigurimit shëndetësor ajo nuk ka plotësuar një nga kriteret e rëndësishme kriterin e dëshmisë së adresës së vendbanimit të aplikueses e rregulluar me nenin 3, paragrafi 4 pika 4.4 të Rregullores Zgjedhore Nr. 04/2025, për Regjistrimin dhe Votimin jashtë Kosovës të KQZ-së.

Megjithatë, përveç këtyre dokumenteve, sipas procedurave të KQZ-së, kërkohet në veçanti, dhe është e detyrueshme që bashkëngjitja e fotografisë së aplikuesit me dokument



identifikues të Kosovës në dorë të jetë pjesë e kundërshtimit, kusht ky që në rastin konkret nuk është përmbushur, e kjo e paraparë me dispozitën e nenit 3 paragrafi 5 pika 5.4 të Rregulloren Zgjedhore Nr. 04/2025, për Regjistrimin dhe Votimin jashtë Kosovës të KQZ-së.

Ky kriter specifikon që aplikuesi duhet të ngarkojë një fotografi të tij, në të cilën ai duhet të mbajë dokumentin e tij të identitetit siç është letërnjoftimi në dorë, duke mundur që verifikimi të bëhet vizualisht dhe në mënyrë të çartë.

Në rastin konkret, aplikuesja ka ngarkuar një foto të pasaportës dhe sigurimit shëndetësor, por nuk ka plotësuar kërkesën e KQZ-së, për fotografi të vetvetes duke mbajtur dokumentin e identitetit por kjo foto nuk ka përmbushur kërkesën e verifikimit të identitetit, pasi nuk përmbante elementin e domosdoshëm: aplikuesi të jetë i pranishëm në foto duke mbajtur dokumentin në dorë, dhe kjo ka rezultuar në mos plotësimin e kriterëve të rregulluara me rregulloren e lartëcekur.

Prandaj, nga arsyet e theksuara më lart si dhe duke u bazuar në dispozitat e nenit 117 paragrafi 3, 118 paragrafi 1, neni 119 paragrafi 3 të Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, nenit 3 paragrafi 4 pika 4.4 e lidhur me nenin 3 paragrafi 5 pika 5.4 e Rregullores Zgjedhore Nr.04/2025, për Regjistrimin dhe Votimin Jashtë Kosovës, dhe në bazë të Rregullores Nr.01/2025 për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave, Paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**

ZL.A.nr. 10/2025 më datën 06.09.2025



**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.